



This project is funded  
by the European Union



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



INSTITUTE FOR POLITICAL STUDIES  
www.isp.com.al



## ROLI I FINANCIMIT NË FUSHATËN ZGJEDHORE: ENDE NJË KOSTO PËR SHQIPËRINË DREJT BE-SË

**Nga Herlina MUÇA**

Si çdo person juridik, ashtu dhe partitë politike kanë nevojë për financime. Por roli i parave në politikë është bërë sot një ndër kërcënimet serioze për demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Ky është një problem global dhe deri diku paraqet vështirësi për tu trajtuar nga një vend në tjetrin.

Mënyra e financimit të fushatave zgjedhore në vendin tonë shpesh ka qenë objekt kritike për ekspertët dhe organizatat e huaja të cilat vlerësojnë se nuk sigurohet mjaftueshëm transparencë mbi këto fonde dhe nuk hetohen mjaftueshëm indikacionet për keqpërdorimin e tyre.

Në një demokraci pluraliste, për përballimin e veprimtarive të tyre, çdo parti dhe zyrtarët e saj kanë nevojë për mbështetje financiare, që garantohet nga burime publike apo private apo dhe nga kombinimi i këtyre të dyjave. Kjo mbështetje është e një rëndësie primare për partitë politike kur vjen puna tek përballimi i fushatave elektorale. Me fushatë elektorale llogaritet çdo aktivitet, tubim, takim me qytetarët, promovim dhe prezantim i programit zgjedhor të një partie politike ose koalicioni që garon në zgjedhje.

Financimi i partive politike është aktivitet publik dhe transparent për publikun. Të paktën kështu e parashikon kuadri ligjor shqiptar. Qytetarët dhe organet kompetente shtetërore duhet të kenë qasje të plotë deri te raportet financiare të partive. Qytetarët duhet ta dinë se një pjesë të këtyre mjeteve i marrin nga taksapaguesit

---

*Fituese në konkursin me ese "Mbi pikëpamjet e të rinjve mbi partitë politike dhe rolin e tyre në promovimin e demokracisë në Shqipëri. Realizuar në kuadër të projektit "Unë marr pjesë! Zëri im, vota ime vlen", i cili po jetësohet nga Instituti i Studimeve Politike (ISP) në bashkëpunim me Komitetin Shqiptar të Helsinkit (KSHH) dhe Civil Rights Defenders (CRD), me mbështetjen e Bashkimit Europian.*

nëpërmjet të ardhurave që grumbullohen në buxhetin e shtetit. Një pjesë tjetër vjen nga anëtarët, bizneset private dhe aktivitetet promovuese.

Ajo që vlen për tu theksuar është se mënyra e financimit të partive politike mbetet esenciale për integritetin e procesit zgjedhor, prandaj dhe transparenca financiare përbën një element demokratik për të cilin secili qytetar duhet të jetë në dijeni në çdo moment dhe sidomos përpara procesit zgjedhor.

Aktet ligjore në fuqi në vendin tonë lejojnë që partitë politike të marrin mbështetje materiale dhe financiare nga kuotat e anëtarësimit, fondet publike dhe fondet private<sup>1</sup> për kryerjen e veprimtarisë së tyre. Por në të njëjtën kohë, Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor aktual janë ato që e kërkojnë transparencën mbi mënyrën e financimit të partive politike. Transparenca e financimeve në nivelin e Kushtetutës së Republikës, kërkon që burimet financiare të partive politike, si dhe shpenzimet e tyre duhet të bëhen kurdoherë publike<sup>2</sup>.

Sa i përket financimit të fushatave zgjedhore, Kodi Zgjedhor lejon si burime financimi: fondet e dhëna nga Buxheti i Shtetit për partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore; të ardhurat e vetë subjektit zgjedhor; dhuratat për subjektin zgjedhor dhe kandidatët e tij, në vlerë monetare, natyrë ose shërbime; si dhe huat ose kreditë e marra nga partitë politike ose kandidatët e tyre sipas ligjit.<sup>3</sup> Ndalohet financimi i fushatave zgjedhore nga fonde, dhurata apo shërbime pa kundërshtëpërlim, të dhëna nga persona fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, jashtë rasteve dhe rregullave të parashikuara nga Kodi Zgjedhor. Vetë KQZ-ja ka të drejtën të verifikojë drejtpërdrejt të ardhurat dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore për çdo parti politike të regjistruar si subjekt zgjedhor, apo kandidatët e propozuar nga zgjedhësit.

Kodi Zgjedhor i ndryshuar ka sjellë përmirësime cilësore në kuadrin e transparencës financiare, por përsëri është vullneti i institucioneve përgjegjëse kontrolluese si dhe vullneti i partive nga ana tjetër që ta zbatojnë si duhet atë, duke siguruar kështu një proces zgjedhor sa më demokratik për shoqërinë shqiptare. Ekspertët dhe studiuesit theksojnë gjithashtu se Kodi i ri Zgjedhor sjell përmirësime të ndjeshme në shmangien e përdorimit të administratës publike në zgjedhje, një aspekt tjetër pozitiv ky për procesin zgjedhor.<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> Neni 17 Ligji nr. 90/2017, datë 22.05.2017 “Për Partitë Politike”

<sup>2</sup> Neni 9 pika 3 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë: *“Burimet financiare të partive, si dhe shpenzimet e tyre bëhen kurdoherë publike.”*

<sup>3</sup> Neni 86 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë

<sup>4</sup> [www.zeriamerikes.com](http://www.zeriamerikes.com) “Shqipëri, financimi i partive politike në fushatën zgjedhore në qendër të një studimi mbi Kodin e ri Zgjedhor”

Sado që fushata elektorale zhvillohet në prani të qytetarëve, vetëm nëpërmjet medias shpërndahet informacion dhe analizë në shkallë të gjerë mbi aktualitetin dhe perspektivën e zgjedhjeve. Partitë politike janë duke shfrytëzuar si mediat kryesore kombëtare ashtu dhe ato lokale, për t'u siguruar se mesazhet dhe premtimet e tyre mbërrijnë tek elektorati për të marrë përkrahjen dhe votat që u nevojiten. Duke ditur se media ka një pushtet të pakrahasueshëm, atë të informacionit, duhet theksuar se ekziston mundësia dhe dëshira për të korrupuar njerëz të medias për qëllime të caktuara elektorale dhe kjo mund të sjellë precedent të rrezikshëm në ngjarjet që pasojnë për një shoqëri si e jona, aspirante për integrimin në BE.

Por pavarësisht nga kjo, forcat kryesore politike në vend ia kanë dalë që të bëjnë për vete pronarë të mediave, dhe në këmbim të favoreve reciproke, të ndikojnë në politikën editoriale të mediave të tyre deri në atë masë sa publiku i percepton ato si media të njëjës apo tjetrës parti.<sup>5</sup> Krahas faktorit pronësi, një rol të konsiderueshëm në shkallën e varësisë apo të pavarësisë së mediave ka luajtur edhe financimi i tyre. Vihet re që mungon ende një transparencë e plotë për burimet e financimit pasi manipulohen apo fshihen prej tyre.

### ***Rekomandime dhe sugjerime***

Politika është një ndër sektorët që vuan më tepër nga informaliteti financiar në Shqipëri. Në themel, edhe pse financimet politike publike dhe private janë të domosdoshme për të mbuluar kostot e drejtimit të një partie dhe fushatës së saj elektorale, ato gjithashtu janë një burim korrupsioni kur bëhen në mënyrë informale. Për përmirësimin e situatës lidhur me financimin e partive politike dhe që ky drejtim të mos mbetet ende një kosto për vendin tonë drejt Bashkimit Europian, unë do të jepja disa rekomandime:

- ❖ *Së pari*, pjesë ku nevojiten përmirësime në ligj janë auditimet e vet KQZ-së. Sipas gjykimit tim veprimtaria financiare e secilës parti duhet të kontrollohet dhe publikohet edhe gjatë fushatës zgjedhore. Në të kundërt, publiku nuk mund ta njohë mënyrën sesi po zhvillohet fushata zgjedhore dhe të krijojë një opinion përpara se të shkojë në votime.
- ❖ *Së dyti*, nga ana e autoriteteve ligjore përkatëse, duhet të përdoren metoda të ndryshme monitorimi, përfshirë dhe ato investigative, për të dokumentuar shpenzimet elektorale të partive politike. Këto të dhëna më pas duhet të bashkohen dhe të krahasohen me fondet që partitë deklarojnë pas përfundimit të zgjedhjeve. Kjo mënyrë krahasimi do të ndihmojë në mënyrë të

---

<sup>5</sup>Rrapo Zguri “Marrëdhëniet mes medias dhe politikës në Shqipëri” faqe 28

dukshme në nxjerrjen e të dhënave konkrete për mënyrën e përdorimit të financave nga partitë politike.

- ❖ *Së treti*, duhet të bëhen publike dhe transparente të dhënat mbi pronësinë e mediave private në vend, në mënyrë që të zbulohen ndikimet dhe lidhjet e mundshme politike në kronikat e tyre editoriale, sidomos gjatë periudhës së fushatës elektorale.
- ❖ *Së katërti*, gazetarët duhet të përgatiten mirë për mbulimin e fushatës zgjedhore, të bëhen gjithnjë interpretues të çështjeve politike, duke marrë një rol aktiv, skeptik dhe këmbëngulës ndaj politikanëve dhe duke siguruar kështu transparencën për qytetarët shqiptarë.

Si përfundim, është themelore për shoqërinë shqiptare, që pjesë të perspektivës së saj ka dhe anëtarësimin drejt Bashkimit Evropian, që partitë politike të respektojnë në mënyrë korrekte kuadrin ligjor në fuqi për financimin e partive politike dhe të bëjnë publike kurdoherë raportet e tyre financiare pa patur nevojë për ndonjë presion të jashtëm. Vetëm në këtë formë do të sigurohej transparenca dhe partitë politike do të ishin promovuese të vlerave demokratike në Shqipëri, duke sjellë në këtë mënyrë përshpejtimin e rrugës drejt integritit të plotë evropian të vendit tonë.